



Datë: 11.03.2025
Numër Protokolli: 1636/2025

A.nr.221/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetar, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtare, me Ylber Fetahaj , si procesmbajtës, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.221/2025 të datës 27.01.2025 të parashtruar nga ankuesi N.M, kundër organit të punësimit/ Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “*Kompensim Material*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 11.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.221/2025, të datës 27.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, N.M.
- II. Pala udhëzohet të drejtohet ne Gjykatën Kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi N.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 27.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 543/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.221/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative në lidhje me kërkesën për kompensim në emër të diferencës në pagë e përpiluar me datën 23.12.2024 ku është drejtuar organit të punësimit përkatësisht Komunës së Gjilanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh faktin se objekt i kësaj çështje ankimore është kërkesë për kompensim në emër të diferencës në pagë e përpiluar me datën 23.12.2024. për përudhen nga data 06.02.2023 deri me 19.11.2023 , Këshilli ka gjetur se ankuesi sipas akt emërimit të datës 15.02.2012 e mbanë pozitën e punës *Zyrtar për Pemëtari* në kuadër të Drejtorisë për Bujqësisë dhe Pylltari në Komunën e Gjilanit ndërsa sipas vendimit me numër Protokolli. 1551 të datës 17.10.2023 ankuesi e ka përfunduar marrëdhënie punës sipas fuqisë së ligjit duke arritur moshën e pensionit me datën 19.11.2023 dhe andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ne rastin konkret duke u bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesit marrëdhënia e tij e punës me rastin e pensionimit i është përfunduar më datë 19.11.2023, kështu që nga kjo datë ankuesin nuk është në marrëdhënie punës, çka nënkupton që nga kjo datë ka humbur edhe statusin e nëpunësit civil, rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kompetencë të shqyrtoj ankesën e ankuesit sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kompetencë që ti shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: ***“Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil”***, andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Marrë parasysh konstatimin si me lartë, se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 221/2025 të datës 27.01.2025 dhe palën ankuesi udhëzon për të shfrytëzuar mjetet juridike në Gjykatën Kompetente, duk u mbështetur në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që pala të udhëzohet në Gjykatën Kompetente për të vazhduar procedurat ligjore.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.221/2025

Ylber Fetahaj

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, N.M;
- Njesisë të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;